

Rezearta Kokonozi mban rolin e Drejtoreshës në Drejtorinë e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit që nga marsi i vitit 2024.

Ka përfunduar një diplomë të integruar të nivelit të dytë në Juridik nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë dhe ka marrë pjesë në shumë trajnime dhe kurse të specializuara, duke përfshirë Kodin e Procedurave Administrative dhe Hartimin e Legjislacionit në Shkollën Shqiptare të Administratës Publike.

Që prej dhjetorit 2024, ka mbajtur rolin, si Drejtoreshë e Mirëadministrimit të Burimeve Njerëzore, Aseteve dhe Shërbimeve në Ministrinë e Kulturës

Në 2020, ka ushtruar funksionin e Drejtoreshës së Koncesioneve, Prokurimeve dhe Partneriteteve në Ministrinë e Kulturës duke treguar fleksibilitet dhe aftësi në menaxhimin e situatave të ndryshme.

E ka filluar karrierën e saj si Specialist Jurist në Qendrën Kombëtare të Veprimtarive Folklorike dhe në Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare në Tiranë, ku ka qenë e angazhuar në procese ligjore dhe administrativë, duke përfshirë hartimin e dokumentacionit dhe pjesëmarrjen në procedurat e prokurimeve publike, duke demonstruar aftësi të shkëlqyera në menaxhimin e burimeve njerëzore dhe në zbatimin e rregullave dhe procedurave ligjore.

Anëtare e Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Jomateriale dhe ka marrë pjesë në hartimin e akteve nënligjore për ligjin "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" si dhe në projektligjin "Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në RSH".

Me një qasje të fokusuar dhe një angazhim të fortë për misionin e saj, ajo vazhdon të kontribuojë në fushën e saj dhe të sjellë ndryshime pozitive në institucionet ku punon.